REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

SHPALLJE PËR VEND VAKANT

PËRGJEGJËS NË KINOTEATRIN "VAÇE ZELA" QËNDRA KULTURORE DHE KLUBI I SHUMËSPORTEVE

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", Urdhërit të Kryetarit me nr.335 datë 07.12.2023 "Për Miratimin e Strukturës Organizative të Bashkisë Lushnje për vitin 2024"; Bashkia Lushnje shpall konkurrimin për vend të lirë pune në pozicionin:

PËRGJEGJËS NË KINOTEATRIN "VAÇE ZELA" QËNDRA KULTURORE DHE KLUBI I SHUMËSPORTEVE

Përshkrimi i përgjithshëm i vendit të punës;

1. Përgjegjësi i Sektorit përgjigjet para Drejtorit të drejtorisë/njësisë ku bën pjesë, për zbatimin e politikave, strategjive dhe planeve të fushës përkatëse, si dhe për sigurimin e mbarëvajtjes së punës së Sektorit në përputhje me ligjet, aktet nënligjore apo aktet rregullatore në fuqi;

2. Është përgjegjës për administrimin e çdo çështje që lidhet me fushën e veprimtarisë te sektorit që mbulon;

3. Përgjegjësi i sektorit duhet të ketë diplomë universitare dhe master shkencor, njohuri shumë të mira të specialiteteve brenda një fushe të caktuar profesionale dhe të politikave dhe programeve lidhur me fushën e specialitetit;

KUSHTET DHE KRITERET ;

- Kandidati për pozicionet "Përgjegjës",duhet të plotësojë kriteret, si më poshtë:

1. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master shkencor", në Shkenca Arti,Menaxhim Arti,Shkenca Shoqërore;

2. Të ketë minimumin 10 vjet eksperiencë pune, në fushën e artit dhe kulturës, të vërtetuar me dokument;

3. Të ketë eksperiencë pune si drejtues;

4. Të ketë kontakte me institucionet homologe;

5. Të ketë përvojë në ndërtimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve me donatorë dhe grupe interesi, si dhe në ngritjen e fondeve prej burimeve të ndryshme.

6. Të zotërojë gjuhën angleze, të shkruar e të folur (përbën avantazh);

-Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

a) Jetëshkrimi CV;

b) Fotokopje të diplomës dhe të listës së notave të noterizuara;

c) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

g) Dëshmi penaliteti

h) Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidati,(përbën avantazh)

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve të bëhet brenda datës 01.06.2024, pranë zyrës së Burimeve Njerëzore.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE